



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.350/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së lartë Ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.350/2021 e datës 08.02.2021, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me qëllim nxitje të urrejtjes ndaj të tjerëve, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1,000.00 (një mijë) euro, për të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përbarimit, për shkak të shkeljes së Kodit në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021

II. Detyrohet Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 08.02.2021 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Vetëvendosje, me të cilën pretendon se mbështetësi i PDK-së, Avni Sylaj në rrjetin social facebook ka përdorë gjuhë të urrejtjes kundër kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosjes Albin Kurti dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje duke shkruajtur “prapaskena e Albin Kurtit gjithmonë ka qenë tradhtia”, një votë për VV, është kundër Kosovës, (pra e ekspozon flamurin e Kosovës). Më tutje vazhdon me fjalët “Shpërndajeni ta shef popullit këtë Esat Pashën 2.feeling important ëith Diaspora PDK and others. Më tutje paraqitësi i ankesës pretendon se kjo gjuhë e urrejtës ka ardhur si pasojë e një manipulimi me video ku Albin Kurti viziton disa qytetarë të Shtërpcës në të cilën video dëgjohen disa qytetarë të Shtërpcës duke brohoritur “Serbija” “Serbija Serbija”.

Sipas parashtruesit të ankesës e vërteta e kësaj videoje është se ajo është manipuluar dhe siç shihet në videon origjinale të mbajtjes së atij takimi nuk është ajo pjesë ku brohoritet “serbia serbia serbija”, e të cilin lajm të pavërtetë e ka mohuar edhe Emilija Rezepe e cila ka qenë prezent në atë takim me Albin Kurtin.

Me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se mbështetësi i PDK-së, Avni Sylaj ka cenuar rëndë nenin 33 par.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, lidhur me nenin 4 par.1 pika k) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së, nr.11/2013.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesë, ka bashkangjitur si provë dy CD dhe fotografitë në cilësi të provës materiale.

Më datë 08.02.2021, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 09.02.2021 në ora 10:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 08.02.2021, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Vetëvendosje duke e cilësuar si të paqëndrueshme për faktin se ankuesi LVV ka marrë të dhëna (postime) të një personi nga profili i tij privat në rrjetin social Facebook dhe për të njëjtin aludon se është mbështetës i Partisë Demokratike të Kosovës dhe se ky profil i Facebook-it mund të jetë edhe jo real pasi që personi në fjalë shpërndan gjëra që aspak nuk kanë të bëjnë me adresimet publike të PDK-së. Ndër të tjera theksohet se subjekti politik PDK ka me qindra mijëra anëtarë, mbështetës dhe simpatizant dhe nuk ka tagër që ti kontrollojë veprimet e tyre personale në profilet private të rrjeteve sociale mirëpo përkundër kësaj PDK në rrjete sociale ka adresuar thirrjet për respektimin e Ligjit për Zgjedhjet dhe gjithë rregullativës ligjore lidhur me zhvillimin e fushatës dhe rregullave që janë përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe ka kërkuar nga të gjithë kandidatët dhe deputetët, anëtarët, mbështetësit dhe përkrahësit e PDK-së që të respektojnë Kodin e Mirësjelljes për Subjektin Politik, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të bërë në CD-të, fotografitë e ofruar si provë materiale e cila është publikuar në rrjetin social facebook të mbështetësit të subjektit politik Partia demokratike e Kosovës, ka vlerësuar se mbështetësi i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe promovimit të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, ka nxitur urrejtjen ndaj subjektit VV, në atë mënyrë që përmes përdorimit të gjuhës denigruese dhe urrejtëse ka bërë krahasimin e personaliteti të kryetarit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me figurën kontraverse dhe të urreyer shqiptare atë të Esat Pashës.

Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 33 pika l), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve”.*

Përveq kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 5 paragrafi 1 pika d) i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku përcaktohet se “subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t’i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)”. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, i’ a dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tyre, të njëjtit e kanë mohuar shkeljen e tillë, por se ka njoftuar se subjekti politik PDK-sw, i ka ftuar simpatizantët e saj që të respektojnë procesin zgjedhor të 14 shkurtit.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së, urdhëroi subjektin politik PDK, që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse i njëjti nuk vepron sipas urdhrorit të Panelit, do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i, në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 paragraf 2, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragraf 1 pika c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 350/2021 më datë 11.02.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.